



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 248, datë 21.12.2020

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE
ME KËRKESËN E SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY - AL” SH.P.K, PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NR. 309, SERIA T11/T15, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/14 prot, datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k, për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1185, datë 10.11.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 309, Seria T11/T15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, data 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin nr. 122, datë 14.10.2015.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 195, datë, 26.11.2020, ka vendosur të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 309, Seria T11/T15, të shoqërisë “ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2021.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/41 prot., datë 28.11.2020 për fillimin e procedurës për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 1185/2 prot., datë 02.12.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj, por kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga posta dhe është ridërguar sërish në datën 16.12.2020.
- Në nenin 16, pika 6, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike,

përcaktohet se Bordi do të marrë vendimin për rinovim ose jo të licencës jo më vonë se 20 ditë pune nga fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi, konform kësaj rregulloreje, ndaj për kërkesën e shoqërisë “ENERGY SUPPLY – AL”, Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 28.12.2020.

- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:
 1. *Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.*
 2. *Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”*
- Duke qenë se shoqëria nuk është njoftuar ende për vendimmarrjen e Bordit në lidhje me kërkesën e saj dhe për dokumentacionin e konstatuar të munguar, po ashtu duke marrë parasysh kufizimet e vendosura për shkak të COVID-19, që mund të kenë ndikuar në mosmarrjen e shkresës nga ana e shoqërisë, vlerësohet zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 20 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 20 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI